



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

---

KPK/Nr. 85 /2025

Datë: 05 shkurt 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.32 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 05 shkurt 2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Miratohet Raporti i Komisionit për Administrimin e Prokurorive për trajtimin e rasteve me kryerës të panjohur (PPP) me rekomandimin sipas opsionit të tretë si në vijim:
  - 1.1. Të vazhdohet me mënyrën e njëjtë të regjistrimit siç është vepruar deri më tani. Sipas këtij opsioni, policia pas ndërmarrjes dhe shterjes së të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore, në konsultim më prokurorin e shtetit do të dorëzoj kallëzim penal me kryes të panjohur, i cili regjistrohet në regjistrin PPP, të cilat do të mbesin të hapura deri në zgjidhjen përfundimtare të rastit, përkatësisht deri në zbulimin e kryesit apo arritjen e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale. Këto kallëzime penale me kryes të panjohur të raportohen në mënyrë të veçantë apo të mos përfshihen në raportet vjetore të sistemit prokurorial dhe të mos përfshihen në analizat statistikore së bashku me kallëzimet penale me kryes të njohur.
2. Obligohet Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që brenda 30 ditëve të nxjerrë Udhëzim të detyrueshëm për zbatimin e këtij raporti.
3. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arbën Haradinaj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit për Administrimin e Prokurorive;
- Z. Besim Kelmendi, U.D. Kryeprokuror i Shtetit;
- Sekretariatit;
- Arkivët të KPK-së.